# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-463458**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Taylor Swift i befason fansat? “The Life of a Showgirl” rikthehet me katër këngë të reja? \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/taylor-swift-i-befason-fansat-the-life-of-a-showgirl-rikthehet-me-kater-kenge-te-reja/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 19:00:13 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 15:16:07 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `73cfa875aa1382d7d7fdc8723e2226d905594caa9a5b256501e0e10b6364f88f` |
| TEKSTI | `0e5a29bfacf780ad7fecb89f19bea32fbbb7e7eeb079990fffe5d934bdd5bbf1` |
| PAMJA | `80a1aadb5c60a095766a4cc6ad2be183b6fa50d1891fcaa641c8fd761988e989` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7fbddf416c5773e9f6cc6751a2d9d7e1867754596ef4bed3cfbf72c602f89ae0` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7fbddf416c5773e9f6cc6751a2d9d7e1867754596ef4bed3cfbf72c602f89ae0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Celebrities Gossip Showbiz

# Taylor Swift i befason fansat? "The Life of a Showgirl" rikthehet me katër këngë të reja?

*Redaksia K*

*23 Shtator 2026*




Taylor Swift kishte vetëm një ditë që kishte ndezur kuriozitetin e fansave me lajmin për këngën e re "Patient Zero", por tashmë surpriza është shumë më e madhe.

**Këngëtarja** ka njoftuar rikthimin e epokës "The Life of a Showgirl" me një version të zgjeruar të albumit, të titulluar "The Life of a Showgirl: The Encore", i cili do të sjellë katër këngë krejtësisht të reja. Publikimi është planifikuar për të premten, më 25 shtator.

Në mesin e këngëve të reja është edhe "Patient Zero", singëlli që Swift e kishte paralajmëruar vetëm një ditë më parë. Tre këngët e tjera janë "Cleveland!", "Pink Clouding" dhe "Babylon".

Lajmin **Swift** e ndau me fansat përmes rrjeteve sociale, duke shpjeguar se këngët e reja lindën krejt papritur gjatë një udhëtimi në Suedi me bashkëpunëtorët e saj, Max Martin dhe Shellback.

> *Rreth një vit më parë, ju bëtë diçka vërtet të pabesueshme. Diçka që më la pa fjalë… Ju i dhatë 'The Life of a Showgirl' javën e parë më të madhe të një albumi në histori*

-shkroi Swift, duke iu referuar pritjes së jashtëzakonshme që pati albumi.

Ajo tregoi se kishte udhëtuar në Suedi me Martin dhe Shellback për të festuar këtë arritje, por gjithçka mori një drejtim tjetër kur pranë tyre ishte një studio regjistrimi.

> *Në të vërtetë, thjesht donim të reflektonim dhe të përjetonim mirënjohjen për momentin në të cilin ndodheshim, por aty kishte një studio dhe ne bëmë atë që bëjmë kur ndiejmë diçka: shkruam më shumë këngë*

-rrëfeu këngëtarja.

**Swift** zbuloi gjithashtu se këngët e reja kanë lindur pikërisht nga mirënjohja për fansat dhe mënyrën se si ata e pritën albumin.

> *Shpresoj t'i doni, sepse ato lindën nga mirënjohja e pastër për entuziazmin tuaj dhe për mënyrën se si e festuat albumin që krijuam. 'The Life of a Showgirl: The Encore', me katër këngët e reja, publikohet të premten*

-shkroi ajo.

"The Life of a Showgirl" u publikua në vitin 2025 dhe versioni origjinal përmban 12 këngë. Mes tyre janë "The Fate of Ophelia", "Elizabeth Taylor", "Opalite", "Father Figure", "Eldest Daughter" dhe kënga titull, "The Life of a Showgirl", në bashkëpunim me Sabrina Carpenter. Versioni i ri e çon listën në 16 këngë.

Rikthimi vjen si një surprizë për fansat, veçanërisht pas gjithë misterit të krijuar rreth "Patient Zero". Vetëm një ditë para njoftimit për "Encore", Swift kishte zbuluar se kënga e re do të publikohej më 25 shtator, pas një serie të dhënash misterioze në faqen e saj dhe në rrjetet sociale.

Dhe fansat nuk do të duhet të presin gjatë. "The Life of a Showgirl: The Encore" publikohet më 25 shtator, duke sjellë katër këngë të reja dhe duke zgjatur edhe më tej epokën e albumit të 12-të të Swift.

**LAJME TË NGJASHME**








Një bluzë 40 dollarëshe e Taylor Swift u shit gjatë ndeshjes/ Fuqia e saj mbi modën po shfaqet edhe në stadium!

2.5 MIN



Taylor Swift shfaqet në stadium për Travis Kelce duke "braktisur" Emmy-t!

2 MIN



Taylor Swift dhe Travis Kelce shfaqen në New York pas martesës!

1.5 MIN



Harry Styles bën shaka për dasmën e Taylor Swift në Madison Square Garden?

1 MIN




Taylor Swift dhuron 50 mijë dollarë për nënën që rrezikoi jetën për të shpëtuar adoleshentët nga aksidenti!

1 MIN

## MË TË LEXUARAT



"E kam nisur nga terreni, më pëlqen më shumë…"/Gazetarja Trevisa Tufa: Kur të jetë mundësia më e mirë në kohën e duhur…



Ish-banorja e "BBV", Amber surprizon me transformimin e ri/FOTO!



Parkim me pagesë nga 5 tetori në Durrës, ja sa do të paguajnë qytetarët dhe çfarë përfitojnë rezidentët



Njihuni me ishullin ku derrat notojnë me turistët!



Seriali kriminal që po çmend Netflix-in, 12.2 milionë shikime në vetëm katër ditë? Cili është?



De Rossi ende nuk i jep minuta në Serie A mbrojtësit të Kombëtares shqiptare Mario Mitaj!



Premier League/ Manchester City është i pandalshëm, tre pikë edhe për Liverpoolin!



Serie A/ Fiorentina frenon Napolin në barazimin 1-1!



Dënimi i ish-krerëve të UÇK në Hagë, Tedi Blushi kërkon interpelancë me Ramën: Duhen



"Duhet të sillen mirë"/ Trump paralajmëron Iranin: Ose marrëveshje, ose do t'iu

hapa konkrete nga qeveria!

shkatërrojmë!

## EDITORI SUGJERON



3 zakone fitnesi që duhet të filloni në moshën e mesme për një plakje të shëndetshme!



Mos e konsumoni kreatinën pluhur të thatë, një dietolog shpjegon mënyrën më të mirë për ta marrë!




Farat chia kundrejt farave të lirit, cilat kanë më shumë fibra dhe yndyra të shëndetshme?!




Lëng portokalli apo kafe: cili është më i mirë në mëngjes?!



Somelieri Fatjon Tila: Historia e një pasioni për verën e lindur në Itali...



"Pin territorin, jo vetëm verën..."/ Fation Tila, udhëtimi ekskluziv i një somelieri shqiptar në kantinat italiane...



Trevisa Tufa analizon Kombëtaren: Çfarë pritet nga trajneri Maran në Ligën e Kombeve...



"Jam shumë e brishtë, kam nevojë për prindërit..."/A do të hynte Trevisa Tufa në Big Brother? "Do kaloja në nivel super sajan..."



"E kam nisur nga terreni, më pëlqen më shumë..."/Gazetarja Trevisa Tufa: Kur të jetë mundësia më e mirë në kohën e duhur...




Avokado apo gjalpë arrash në tost: cili ka më shumë proteina dhe fibra?!

**RRETH NESH**

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.


**KONTAKT**

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:
[email protected]

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873


**COPYRIGHTS**

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

**LINKS**

- Kontaktoni
- Marketing
- Frekuencat
- Aksesueshmëria
- Mundësi Punësimi
- Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.